



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

**DREJTORIA E PROJEKTIMIT DHE AZHORNIMIT TOPOGRAFIK
SEKTORI I PROJEKTIMIT**

Elbasan më __/__/2023

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: "INVESTIME NE FUSHAT SPORTIVE (IMPIANTI I VADITJES DHE DRENAZHIT, NE FUSHEN E KOMPLEKSIT SHEFQET LAMÇJA" DHE RIKONSTRUKSIONI I TERRENEVE SPORTIVE TE SHKOLLES SE BASHKUAR, SHUSHICE)

Investitori: Bashkia Elbasan

Projektuesi: Drejtoria e Projektimit dhe Azhornimit Topografik

Vendndodhja: Bashkia Elbasan

Përmbatja:

1. Te pergjithshme
2. Te dhena dhe kerkesa te projektit
3. Gjendja ekzistuese e fushes se futbollit
4. Impianti i vaditjes dhe drenazhimit te fushes

1. Te pergjithshme

Pasi jemi njohur me detyren e Projektimit, sektori i projektimit është angazhuar me të gjithë stafin duke përfshirë të gjitha disiplinat e projektimit për të bërë të mundur realizimin e projektit.

Bazuar në kërkesat e detyres së projektimit dhe një kushtet teknike të projektimit për objektin **"Impianti i vaditjes dhe drenazhimit në fushën e kompleksit "Shefqet Lamçja", Bashkia Elbasan**, sektori i projektimit ka propozuar një projekt i cili ofron një zgjidhje funksionale dhe arkitektonike në përputhje me KTP dhe KTZ.

Natyra e ndryshme e punës kërkon një analizë të thelluar të kushteve të zonës në studim duke bërë një analizë të thelluar.

Projekti propozon një objekt i cili plotëson të gjitha kushtet konstruktive dhe strukturore për sipas KTZ dhe ligjit për projektimin e godinave.

Gjatë projektimit është marrë parasysh që objekti të plotësojë të gjitha kushtet si: Eficencë në funksionimin e hapësirave, ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit në mënyrë të përhershme, siguri dhe mbrojtjen nga zjarri, uji dhe rreziku nga dora e njeriut.

Për të realizuar një objekt i cili ofron një funksionim sa më të integruar të sistemeve për menaxhimin e ndërtesave, grupi i projektimit ka përfshirë të gjithë stafin e inxhinierëve në këtë projekt.

2. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Mbeshtetur në kërkesat e projektit kërkohet projektimi i implantit të vaditjes dhe drenazhimit të fushës së sportit. Nderhyrjet që do të realizohen janë si më poshtë:

- Projektimi i fushës së sportit
- Projektimi i implantit të vaditjes dhe drenazhimit të fushës.


3. Gjendja ekzistuese

Hapesira qe do nderhyet eshte nje hapësire boshe, qe sherben si nje terren sportiv pa nje infrastrukture te pershtatshme per te cilen do te kryet projektimi i impiantit te vaditjes dhe drenazhimit sipas kushteve teknike te projektit duke krijuar nje hapësire moderne qe do ti sherbeje ekipeve te moshave te Akademise se Futbollit Elbasani.



Foto te gjendjes ekzistuese te fushes se sportit

Figure 1. Plani i fushes



Fusha e sportit do te kete dimennsione 103m x 67m dhe nje hapesire perreth me gjeresi 4.3 m e cila do te shfrytezohet per vrapim. Fusha do te jete e parametrave optimal per zhvillimin e stervitjeve dhe ndeshjeve te futbollit qe do te kryen nga sportistet, duke perfshire nje sistem drenazhimi per te realizuar drenazhin e shpejte te fushes, ndricim per te mundesuar zhvillimin e aktiviteteve ne cdo periudhe. Drenazhimi do te kryehet do te behet me tuba te brinjezuar drenazhi SN4 Φ 150mm (perkatesisht 7 cope) te vendosur ne distance nga njeri tjetri cdo (14.3m, 18.6m, 13.8m) duke shkarkuar ne linjen kryesore ne 7 puseta b/a dhe tub i brinjezuar dfrenazhi SN8 Φ 400mm qe do te shkarkoje ne nje pusete kontrolli e vendosur ne juglindje te fushes, qe plotesojne te gjitha kushtet teknike dhe kerkesat e projektit.

Vaditje e fushes eshte llogaritu me sprucator duke bere furnizimin sipas skemes ne projekt.

Sprucator per ujitje 22cm, rrezja 360°, presioni 2.1-6.2Atm, rrezja mbuluese 11.9-19.8m, 660-4930Lt/h, filetim 1" .Sprucator për vaditje (RainBird 6504). Sprucatori shërbën për hedhjen e ujit dhe vaditjen e kopshteve tuaja. Ky sprucator është i montuar nëntokë dhe del në sipërfaqe ne momentin e vaditjes. Lidhet me elektosaracineskën dhe panelin komandues për të kryer vaditjen në mënyrë automatike. Me këtë sistem ju mund të vadisni ne kohën që dëshironi pa pasur nevojë të jeni prezent. Gjithashtu sistemi automatik i vaditjes përmirson eficientë e përdorimit të ujit, duke e kursyer atë. Hedhja e ujit mund të regjistrohet me anë të një kacavide petë, regjistron këndin e hedhjes së ujit 360° dhe largësi nga 11-20 metra. Ky sprucator është i përshtatshëm për parqe, fusha futbollit, ambinete industriale, etj. Megatek iu ofron shërbim dhe asistencë pa pagesë për përgatitjen e skicës teknike dhe listës së materialeve në varësi të nevojave dhe ambjentit tuaj

- Gjatësia totale: 21.6cm
- Presioni: 2.1 bar - 6.2 bar
- Masa: 1" femër
- Marka: RAIN BIND
- Per 17 sprucator = 83.81 m3 uje per 1 ore



1. Depozita e ruajtjes së ujit

Është depozita që furnizon dhe ka kostant sasinë e ujit. Depozita e një rezervuar uji prej konstruksioni rrethor, të galvanizuar prej çeliku, i kompletuar me astar EDPM 1.00 mm, me dalje valvul izoluese dhe dalje për lidhjen me tubacione e pompës brenda 3 metrave.

2. Pajisjet e pompës

Furnizoni dhe instaloni një njësi pompë shumëfazëshe trefazore. Njësia e pompës është e kompletuar me valvul pa kthim, valvul për lehtësimin e presionit të kthyer në rezervuar, valvul kontrolli automatik i cili do të hapet kur pompa të fillojë dhe do të mbyllet kur të ndalojë.

3. Spërkatës, valvola kontrolli dhe kontrollues automatik,

Furnizon valvulën në spërkatësit nepermjet nje galixhanti

Ing. Hidroteknik

ing.Arian BAKU

Ing. Hidroteknik

ing.Bruno Korumi

Drejtori D.P.A.T-se

ark.Marvis Avllazagaj

KRYETARI I BASHKISE

GLEDIAN LLATJA

RELACION
TEKNIK
ARKITEKTONIK

NDËRTIMI I TERRENEVE
SPORTIVE NË SHKOLLËN "9-
VJECARE SHUSHICE"

BASHKIA

ELBASA

Në aspektin e zonimit funksional, kjo shkollë është përzgjedhur me bazë vendodhjen e saj dhe krijimi i terreneve sportive në këtë shkollë krijon mundësinë e shfrytëzimit të tyre nga banorët e zonave përreth. Duke i parë veçanësisht nga njëra tjetra mund të themi se shkolla 9 vjeçare Shushice mbulon kërkesat për terrene sportive për nxënësit dhe banorët e zonës.

2 ZONAT E PROJEKTUARA

2.1. Përshkrim i përgjithshëm

Projekti parashikon ndërhyrje përmirësuese në lidhje me problematikat e hasura, shtimin e funksioneve aktuale, ruajtjen dhe përmirësimin e sipërfaqeve të këndeve sportive në shkollën e 9 Vjeçare të Njesisë Administrative Shushice në Elbasan. Projektimi ka patur në konsideratë frekuentimin e këtyre terreneve jo vetëm nga nxënësit por dhe nga banorët e zonave përreth.


Fushat e minifutbollit dhe basketbollit

Problematika

Fushat e volejbollit dhe futbollit nuk ekzistojnë të konturuara në asnjë prej terreneve sportive. I gjithë terreni ku zhvillohet loja është dhe i ngjeshur, një sipërfaqe e cila nuk plotëson as kërkesat minimale për zhvillimin e këtij aktiviteti sportiv.


Projektimi.

Fushat e volejbollit / basketbollit janë projektuar të veçanta nga ato të minifutbollit




Rrjetat e volejbollit janë ndarja kryesore dhe elementi ndarës midis dy skuadrave në një lojë volejboli. Duke e ndarë fushën në mes, lartësia e rrjetës dikton sesi skuadrat do të luajnë strategjinë e tyre për të fituar lojën. Rrjetat e volejbollit zakonisht bëhen me rrjetë najloni të zezë me shiritat të bardhë koke.

Rrjetat e volejbollit shtrihen në të gjithë gjerësinë e fushës 9 m dhe mbahen të ngurtë nga shtyllat e jashtme të vendosura zakonisht 0.91 m nga fusha. Lartësia qendrore e një rrjete volejboli ndryshon për lojërat e meshkujve dhe femrave me rrjetat e meshkujve të rregulluara në lartësinë



Ka shumë materiale që mund të përdoren për një fushë basketbolli në natyrë, por tre opsionet më të njohura janë betoni, asfalti dhe terreni sintetik. Betoni është opsioni më i



Shtresat

Shtresat e perdorura ne fushat sportive te minifutbollit jane marre nga kushtet teknike te percaktuara nga F.SH.F. per kete qellim.

Projektimi

Projektimi i terreneve sportive është kryer duke marrë në konsideratë jo vetëm nxënësit e shkollës përkatëse por dhe banorët e zonave përreth. Shfrytëzimi i këtyre terreneve do të kryhet nga nxënësit e shkollës jo vetëm gjatë orës së mësimit por dhe në kohën e tyre të lirë. Gjithashtu banorët e zonave përreth do të shfrytëzojnë këto terrene sportive gjatë pasdites dhe fundjavës. Gjithashtu këto terrene mund të mirëpresin dhe aktivitete të ndryshme sportive të zhvilluara në rang shkolle apo në rang qyteti. Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër është e nevojshme që të gjitha terrenet sportive të jenë të ndriçuara sipas standardeve dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme për mirëfunktionimin e tyre dhe gjatë orëve të pasdites apo të mbrëmjes.

HARTOI

Arkitekthe Gladiola Çala



Ing.Hidroteknik Arian BAKU

Specialist Amarildo Ahmati



*Drejtori D.P.A.T
Ark.Marvis AVLLAZAGAJ*

KRYETARI BASHKISE

Gledian LLATJA

RELACION TEKNIK

NDËRTIMI I TERRENEVE
SPORTIVE NË SHKOLLËN
"9-VJECARE SHUSHICE"

BASHKIA ELBASAN

1. GJENDJA EKZISTUESE



Hyrje

Projekti 'Kënde Sportive për shkollën 9- Vjecare Shushice', konsiston në rimodelimin e këndeve sportive të shkollës në njesinë Administrative Shushice në qytetin e Elbasanit. Sipërfaqja në të cilën do të ndërhyhet përfshin të gjitha sipërfaqet e këndeve sportive të shkollës, të cilat në tërësinë e tyre do të mundësojnë zhvillimin e lëndës së edukimit fizik në përputhje me standardet dhe do të japin më shumë jetë si dhe funksione të ndërthurura mirë këtyre shkollave të qytetit të Elbasanit.

1.1. Zhvillimet aktuale

Këndet sportive të trajtuara në këtë projekt u përkasin shkollës "9- Vjecare Shushice"
Sipërfaqja e këndeve sportive ekzistuese të kësaj shkolle është një sipërfaqe e

konsiderueshme por që për një kohe të gjatë nuk është kryer asnjë investim dhe pavarësisht mirëmbajtjes së veglave gjimnastikore dhe elementëve të tjerë përbërës të fushave, degradimi i tyre ka qenë i pashmangshëm për shkak të vjetërsisë. Gjithashtu në një pjesë të terreneve nuk ekziston asnjë lloj shtrimi dhe terreni të përshtatshëm për kryerjen e aktiviteteve sportive. Gjendja ekzistuese e terreneve sportive ilustron me anë të fotografive të mëposhtme:

Shkolla 9 vjeçare 'Shushice'

Terreni sportiv ekzistues përbëhet nga një sipërfaqe e konsiderueshme në të cilën nuk ekziston asnjë element terreni sportiv përveç se porta metalike të cilat përdoren në rastet kur luhet futboll, por dhe këto në një gjendje shumë të degraduar. Kjo shkollë frekuentohet nga rreth 973 nxënës dhe vendodhja e saj është në fshatin Shushice, Njesia Administrative Shushice.

1.1. Marrëdhënia funksionale me zonat përreth

Në aspektin e zonimit funksional, kjo shkollë është përzgjedhur me bazë vendodhjen e saj dhe krijimi i terreneve sportive në këtë shkollë krijon mundësinë e shfrytëzimit të tyre nga banorët e zonave përreth. Duke i parë veçan nga njera tjetra mund të themi se shkolla 9 vjeçare Shushice mbulon kërkesat për terrene sportive për nxënësit dhe banorët e zonës.

2 ZONAT E PROJEKTUARA

2.1. Përshkrim i përgjithshëm

Projekti parashikon ndërhyrje përmirësuese në lidhje me problematikat e hasura, shtimin e funksioneve aktuale, ruajtjen dhe përmirësimin e sipërfaqeve të këndeve sportive në shkollën e 9 Vjeçare të Njesisë Administrative Shushice në Elbasan. Projektimi ka patur në konsideratë frekuentimin e këtyre terreneve jo vetëm nga nxënësit por dhe nga banorët e zonave përreth.

2.2. Fushat e minifutbollit dhe basketbollit

Problematika

Fushat e volejbollit dhe futbollit nuk ekzistojnë të konturuara në asnjë prej terreneve sportive. I gjithë terreni ku zhvillohet loja është dhe i ngjeshur, një sipërfaqe e cila nuk plotëson as kërkesat minimale për zhvillimin e këtij aktiviteti sportiv.



Projektimi.

Fushat e minifutbollit dhe volejbollit janë projektuar të ndërtohen në të gjitha terrenet sportive.

2.4. Terrenet e gjimnastikes.

Terrenet e gjimnastikës nuk ekzistojnë të konturuara në asnjë prej terreneve sportive. Veglat e ndryshme të gjimnastikës janë vendosur në pika të caktuara të terreneve sportive por gjendja e tyre është tepër e degraduar duke shkaktuar mungesë sigurie në përdorimin e tyre. I gjithë terreni ku janë vendosur veglat e gjimnastikës është dhe i ngjeshur, dhe në shumë raste sipërfaqja është e papastër nga gurët dhe elementë të tjerë që mund të shkaktojnë lëndime gjatë përdorimit të tyre

Projektimi

Terrenet e gjimnastikës janë projektuar të ndërtohen në të gjitha terrenet sportive. Ato do të kenë në përmbajtje të tyre tra ekuilibri të gjatësive të ndryshme dhe paralele të formave dhe lartësive të ndryshme si dhe struktura më komplekse për gjimnastikë. Sipërfaqja ku do të vendosen veglat do të nënshtrohet pastrimit dhe sistemit në mënyrë që të mos ketë elementë që mund të shkaktojnë dëme në përdoruesit e tyre.

2.7 Shtresat

Shtresat e perdorura ne fushat sportive te minifutbollit jane marre nga kushtet teknike te percaktuara nga F.SH.F. per kete qellim.

2.8. Ndiriçimi i terreneve sportive

Problematika

Asnjë prej terreneve sportive nuk është i ndriçuar.

Projektimi

Projektimi i terreneve sportive është kryer duke marrë në konsideratë jo vetëm nxënësit e shkollës përkatëse por dhe banorët e zonave përreth. Shfrytëzimi i këtyre terreneve do të kryhet nga nxënësit e shkollës jo vetëm gjatë orës së mësimit por dhe në kohën e tyre të lirë. Gjithashtu banorët e zonave përreth do të shfrytëzojnë këto terrene sportive gjatë pasdites dhe fundjavës. Gjithashtu këto terrene mund të mirëpresin dhe aktivitete të ndryshme sportive të zhvilluara në rang shkolle apo në rang qyteti. Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër është e nevojshme që të gjitha terrenet sportive të jenë të ndriçuara sipas standardeve dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme për mirëfunktionimin e tyre dhe gjatë orëve të pasdites apo të mbrëmjes.

HARTOI

Ing. Eleketrik **Bledian HYSA**
Specialist **Amarildo Ahmati**
Ing. Gjeodet **Gentjana Kerri**

Drejtori D.P.A.T
Ark. **Marvis AVLLAZAGAJ**



KRYETARI BASHKISE
Gledian LLATJA

